



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e
Komuniteteve dhe Kthim**

Legjislatura e III-të

Nr. 17/09

Prishtinë, më 4.02.2009, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Sadik Idriz, Numan Balić, Hafize Hajdini, Kosara Nikolić, Müfera Şinik, Zafir Berisha, Enis Kervan.

Anëtarët jo të pranishëm: Xhevdet Neziraj, Mursejl Haljilji, Zylfi Merxha, Hetem Arifi.

Gjithashtu të pranishëm ishin: moniturues nga Zyra e Presidentit, KDI, OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 27 janar 2009
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe planifikim Hapësinor, me amendamente
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis me raportin e komisionit funksional -Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2008
6. Prezantimi i Draft – Planit të Punës së Komisionit për vitin 2009
7. Të ndryshme.

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 27 janar 2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 27 janar 2009, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis me raportin e komisionit funksional -Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor,me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

5. „Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2008

Sanije Aliaj, propozoi që në kuadër të raportet të futet një pikë e veçantë që tregon takimet që ka pasur Komisioni me përfaqësuesit ndërkombëtar dhe me institucionet vendore. Ky plotësimi të parashihet edhe në tabelën në fund. Përndryshe me plotësimin e këtyre vërejtjeve përkrahu miratimin e raportit.

Sadik Idriz, theksoi se raporti tregon gjendjen reale, aktivitetet që ka pasur Komisioni gjatë këtij viti, me të cilat nuk jam i kënaqur, sidomos me vizitat në teren, të cilat ishin të pakta. Kjo tregon nevojën që këtë vit të jemi më aktiv në këtë drejtim. Përkrahu miratimin e raportit.

Kosara Nikolić, raporti paraqet gjendjen reale të punës së Komisionit. U pajtua se si Komision duhet bërë më shumë këtë vit, të merremi me shqyrtimin e të gjitha kërkesave dhe problemeve që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Të vazhdojmë me vizitat në teren, dhe të rekomandojmë institucioneve relevante për përmisimin e kushteve të jetesës së komuniteteve.

Kryesuesi, lidhur me vërejtjet e bëra, theksoi ndër arsyet e mosrealizimit të vizitave është edhe për shkaqe objektive. Sidoqë të jetë theksoi se do të vazhdojmë me vizitat e këtilla, do të rekomandojmë Kryeministrit që të jetë i njohur me gjendjen e jetesës së komuniteteve. Sa i përket mos realizimit të vizitave jashtë vendit, të njëjtin shqetësim e ka paraqitur në takimet që ka pasur me kryetarët e komisioneve, do të shikohet mundësia e realizimit vizitave të këtilla jashtë vendit. Megjithatë vlerësoi punën dhe rezultatet që ka arritur Komisioni.

Numan Balić, theksoi se raporti nuk është sa duhet përmbajtësor. Janë përmendur disa takime që kemi pasur, me ministrin për komunitete dhe kthim, përfaqësuesit ndërkombëtar, ndërsa është dashur të shkruhet më shumë rreth atyre takimeve, për qëllimin dhe konkluzionet që kanë dalur nga ato takime. Gjithashtu është dashur të shkruhet edhe rreth pajtueshmërisë së Komisionit për rritjen e buxhetit të Ministrisë për Komunitete. Po ashtu të shkruhet më tepër për rëndësinë e tryezës e rumbullakët. Z. Balic theksoi se nëse raporti shërben vetëm për nevoja tona mund të kaloj, por nëse duhet të jetë dokument edhe për të tjerët, kështu siç është hartuar nuk do të përkrah, do të duhej plotësuar me vërejtjet e bëra.

Zafir Berisha, kërkoi që raporti të miratohet, me inkorporimin dhe plotësimin e tij në bazë të vërejtjeve të bëra nga anëtarët.

Sadik Idriz, gjithashtu kërkoi që raporti mos të shtyhet por të miratohet me plotësimet e propozuara.

Sanije Aliaj, theksoi se raporti është i përafërt me raportet e komisioneve tjera. Përfshirja e rekomandimeve dhe konkluzioneve nga projektligjet e shqyrtuar apo nga takimet e zhvilluara e bënë atë voluminoz, prandaj kërkoi që vërejtjet e bëra të merren parasysh dhe të inkorporohen si pjesë e raportit dhe të miratohet ai.

Kryesuesi, u pajtua me mendimet që raporti të miratohet, me plotësimin e tij nga vërejte e bëra.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohen raporti i punës së Komisionit për vitin 2008, me mundësinë e plotësimin në bazë të vërejtjeve të paraqitura nga anëtarët e Komisionit.

6. Prezantimi i Draft – Planit të Punës së Komisionit për vitin 2009

Sanije Aliaj, duke komentuar planin e punës, propozoi që vizitat në teren të jenë më të shumta se sa janë planifikuara, së paku një vizitë në muaj. Të fillohet në muajin mars, ndërsa të heqen vizitat e parashikuara në muajin korrik për shkak të pushimeve verore.

Enis Kervan, duke komentuar tabelën për mbikëqyerjen ligjeve, theksoi se vitin e kaluar ka bërë një kërkesë për Komisionin për moszbatimin e të Ligjit për letërnjoftimit në komunën e Prizrenit, ku e dokumentet civile nuk lëshohen në gjuhën turke. Kërkesa e tij nuk është marrë parasysht. Prandaj kërkoj sqarim sa a ka të drejtë apo jo Komisioni të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve.

Sanije Aliaj, duke iu përgjigjur parafolësit, theksoi se mbikëqyerja e ligjeve është ndër objektivat kryesore të komisionit, krahas miratimit të ligjeve, dhe dëgjimi i kërkesave të qytetarëve për projektet që shkojnë në të mirën e të gjithë komuniteteve.

Sadik Idriz, duke u ndërlidhur me diskutimin theksoi se komisioni ka të drejtë të mbikëqyrë ligje dhe se në plan të punës duhet parashihet edhe ligji që planifikohet ta mbikëqyrë këtë vit.

Kryesuesi, u pajtua me propozimet që në planin e punë të përfshihet mbikëqyerja e zbatimit të ligjeve. Në këtë drejtim do të kemi kontakt me përfaqësuesit qeveritar dhe përfaqësuesit ndërkombëtar. Propozoi që të përfshihen dy vizita në teren deri me 15 qershor, dhe dy tjera nga muaji shtator deri në muajin nëntor.

Numan Balić, u pajtua me vizitat e propozuara, kërkoj të parashihen edhe vizita jashtë vendit.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohen Draft – Planit të Punës së Komisionit për vitin 2009, me mundësinë e plotësimit në bazë të propozimeve të bëra nga anëtarët e Komisionit.

7. Të ndryshme.

Enis Kervan, duke pasur parash faktin se komisioni ka të drejtë mbikëqyerjen e ligjeve, kërkoj që më shkresë t’iu drejtohem institucioneve kompetente dhe përgjegjëse dhe të kërkojnë zbatimin e ligjit për letërnjoftimin, i cili nuk po zbatohet në komunën e Prizrenit. Në këtë komunë megjithë faktin se gjuha turke është gjuhë zyrtare, dokumentet civile nuk po lëshohen në këtë gjuhë.

Kryesuesi, u pajtua me këtë propozim dhe premtoi se me një shkresë do t’iu drejtohem Ministrisë së Punëve të Brendshme për të kërkuar zbatimin e ligjit.

Mbledhja përfundoi në ora 14:15

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Bojan STOJANOVIĆ